



KUSHTE TE PERGJITHSHME PER SIGURIMIN BBB

Pasi i Siguruari, i ka drejtuar Shoqerise se Sigurimeve "ANSIG" sha, qe ketu me poshte do te quhet **Siguruesi**, nje kerkese me shkrim, qe njekohesht eshte edhe pyetsor, i cili pranohet qe te formoje bazen per kete sigurim dhe qe sebashku me çdo deklaratye tjeter, te bere me shkrim nga i Siguruari, qe ka lidhje me kete police, konsiderohen te perfshira te perfshira ne te, atehere kjo police deshmon se, me kusht qe i Siguruari ti kete paguar Siguruesit primin e sigurimit te permendur ne Formular dhe sipas periudhave, perjashtimeve, kufizimeve dhe kushteve, Siguruesi do te demshperbleje te Siguruarin siç permendet ne kushtet e sigurimit, per shumat mbi pjesen e zbriteshme te zbatueshme, per demet financiare te drejtperdrejta, pesuar nga i Siguruari qe nga data e hyrjes ne fuqi te polices dhe te zbuluar nga i Siguruari gjate periudhes se polices dhe gjithmone ne vartesi me kufizimet e percaktuara.

KLAUZOLAT SIGURUESE

1. Jobesushmeria e Punonjesve

Per arsy e shkaktuar vetem drejtperdrejt nga nje ose disa veprime te pandershme dhe mashtruese te çdonjerit prej punonjesve te te Siguruari, qe ka si qellim arritjen, dhe qe rezultojne ne perfitim financier vetaik te pa drekte per vehten e tyre, pavarsisht se kryhet vetem apo ne bashkepunim me te tjeret, perfshire humbje te pasurise te ketij (ketyre) punonjesi (sve). Paga, komisjonet dhe shperblimet e tjera, te perfshira ne rritjen e pages, nuk do te perbejne shperblim financier te padrejte.

2. Njesite

- Humbjet e pasurise permes vjedhjes, grabitjes, pretendimeve false apo zhdukjeve misterioze te paspjegueshme, shkaterrimet ose demtimet, sido qe te jene shkaktuar ose prej kujdo, gjate kohes qe kjo pasuri eshte ne njesite e te Siguruari, kudo qe te ndodhet;
- Humbjet e pasurise siç permendet me lart, ndersa eshte ne zoterim te nje klienti, ose perfaqsuesi te nje klienti ne njesite e te Siguruarit, pavarsisht ne se i Siguruari eshte ligjerisht perjegjes per kete humbje, gjithmon ne perputhje me Kushtet e Sigurimit dhe duke perjashtuar ne çdo rast humbjen e shkaktuar nga klienti ose perfaqsuesit te tij.

Kjo klauzole nuk mbulon humbjen ose demtimin e pasurise, kur kjo pasuri eshte ne poste, ne ruajtje ne ndonje shoqeri tjeter, apo shoqeri transportuese.

3. Ne udhetim

Humbjet apo demtimet e pasurise gjate transportimit ne emer te te Siguruarit, pavarsisht se eshte nen ruajtjen e shoqerive siguruese apo transportuese.



Kjo klauzole nuk mbulon humbjet ose demtimet qe tejkalojne humbjet dhe demtimet qo tejkalojne shumen qe i Siguruari mund te perfitoje ose merr sipas:

- a) kontrates se te Siguruarit me shoqerine siguruese ose transportuese;
- b) çdo lloj tjeter mbulimi ne sigurim ose demshperblimi ne fuqi te çdo lloj forme te kryer nga apo ne perfitim te klienteve te kesaj shoqerie siguruese apo transportuese dhe ne kete rast kjo police do te mbuloje vetem pjesen e shumes qe tejkalon kufijte e siperpermendur.

Udhetimi do te filloje nga momenti kur punonjesi ose shoqeria siguruese apo transportuese merr ne dorrezim pasurine nga ose ne emer te te Siguruarit dhe do te perfundoje menjehere me dorezimin ne destinacion nga punonjesi apo shoqeria siguruese apo transportuese.

Kur i Siguruari merr persiper pagesat ose veprime te ngjashme ne emer te nje klienti, udhetimi do te perfundoje menjehere me arritjen ne njesite e klientit.

4. Falsifikimi i Çeqeve

Falsifikimi i çeqeve, per shkak te:

- A. (i) Flasifikimit ose ndryshimit mashtrues te, ose ne çdo çek, leter kredi, fature kembimi valutor;
- (ii) transferimit, pageses ose dergimit nga i Siguruari i çdo lloj fondi apo pasurie nepermjet nje sistemi elektronik te transferimit te fondevet, duke i mirebesuar nje instruksioni original pagese elektronike te marre ne zyren komunikuese te te Siguruarit, instruksion i cili duhet te jete firmosur me firme te plote me dore, nga te pakten dy nenshkrues te autorizuar nga te Siguruarit, por i cili:
- permban firme(a) te falsifikuar te nje nenshkuari te autorizuar te te Siguruarit, firme mbi te cilen mbeshtete i Siguruari; ose
 - permban nje ndryshim mashtrues, mbi te cilen mbeshtetet i Siguruari.

Instruksion pagese elektronik quhet nje instruksion me shkrim i perqatitur nga i Siguruari, qe permban nje numur render, dhe autorizon transferimin, pagesen ose dergimin e fondevet apo pasurise nepermjet nje sistemi elektronik te transferimit te fondevet. Mjeti i mesiperm duhet i nje formati te caktuar, te cilin e njeh punonjesi qe punon me te.

Perjashtimet:

Kjo klauzole nuk mbulon humbjet per shkak te falsifikimit te çdonjerit prej mjeteve te mesiperme, ne se keto mjete jane firmosur ose shtuar ne menyre te rregullt, por jane false persa i perket permbajtjes se tyre. Fjala "falsifikim" ose "i falsifikuar" nuk do te thote dhe as perfshire keto mjete te firmosura ose shtuara ne menyre te rregullt, te cilat jane false persa i perket permbajtjeve.

Fjala "pagese" e nje "promissory note" (dokument borxhi) do te thote shkarkimin nga i Siguruari per kete "promissory note" dhe nuk perfshin blerjen, zbritjen ne vlere, shitjen, dhenien hua ose avancimin ne kete "promissory note".

5. Kartmonedha e falsifikuar

Per shkak te pranimit nga i Siguruari ne mirebesim te çdo kartmonedhe leter ose monedhe te falsifikuar ose ndryshuar, te emetuar ose pretenduar te jete emetuar per te qene mjet pagesash ne vendin ne te cilin eshte vendosur zyra e te siguruarit qe peson humbjen.

6. Demtimi I zyrave dhe inventarit

Per shkak te:

- a) Humbjes ose demtimit te mobiljeve, paisjeve te kancelarise dhe kasafortave brenda zyrave te te Siguruarit, shkaktuar nga vjedhja me thyerje, grabitja, vandalizmi apo veprimeve keqdashese.
- b) Demtimit te ketyre zyrave si rrjedhoje e vjedhjes me thyerje, vandalizmit ose verimeve keqdashese, me kusht qe i Siguruari te jete pronar i ketyre mobiljeve, paisjeve, dhe kasafortave, ose pronari I zyrave eshte perqegjes per kete humbje apo demtim.

Kjo klauzole nuk mbulon humjet apo demtimet e shkaktuara nga zjarri.

KUSHTET PARAPRAKE PER PERGJEGJESINE

Eshte kusht paraprak per çdo perqegjesi, sipas kesaj police, qe i Siguruari duhet te plotesoje kushtetet e meposhteme:

- a) Te kete rregullore, libra, ose udhezime te shkruara, qe mbulojne te gjitha aspektet e mirembajtjes dhe veprimtarise se biznesit te sigruar qe percaktojne ne menyre te qarte detyrat e seicilit punonjes, te cilet duhet te njohin detyrat e veta, percaktuar sa me siper.
- b) Detyrat e seicilit punonjes duhet te jene te percaktuara ne menyre te tille qe asnje punonjes nuk lejohet te kontrolloje nje transaksion nga fillimi deri ne perfundim.
- c) Duhet te vendoset kujdestari e perbashket per ruajtjen e:
 - pasurise ne kasaforta;
 - gjithe çelsave te kasafortave;
 - kodeve, shifrave dhe çelsave te kontrollit.

Me "Kujdestari te Perbashket" kuptohet perdorimi i paisjeve te mesiperme ne pranine dhe nen vezhginin e te pakten nje personi tjeter, i cili do te jete njesoj i perqegjshem per mbrojtjen fizike dhe ruajtjen e njesive ose regjistrimeve te perfshira ne to. Bravat dhe kombinimet e kasafortave duhet te jene rregulluar ne menyre te tille qe asnje person te mund ti hapi ato i vetem.

- d) Duhet te vendoset dhe mirembahet Kontroll i Dyfishte per perdorimin e:
 - te gjitha llojeve te letrave me vlere, mjeteve te shkembyeshme dhe jo te shkembyeshme dhe formave te paemetuara dhe te bardha te ketyre dokumentave;
 - rezerves se çeqeve, drafteve dhe çeqeve te udhetareve te paemetuara;
 - llogarive te palevizhme te depozituesve;
 - kodeve, shifrave dhe çelsave te kontrollit.

Me "Kontroll te Dyfishte" kuptohet qe puna e nje personi ne kryerjen e transaksioneve te verifikohet nga nje person i dyte, dyke u marre te dy me veprimin kontabel.

PERCAKTIME TE PERGJITHSHME

1. "**I Siguruar**" quhet i Siguruari i emeruar dhe percaktuar ne formularin e kesaj police dhe çdo shoqeri bankare bije ne te cilin i Siguruari ka interes kontrollues dhe qe permenden ne kerkesen per sigurim.

-
2. "**Njesi**" zyra qendrore dhe çdo dege dhe/ose agjensi ne te cilat kryhen veprimtari i Siguruari.
 3. "**Punonjes**" quhen perkatesisht nje ose me shume zyrtare, nepunes dhe çdo punonjes tjeter gjate kohes qe eshte punesuar nga i Siguruari.
 4. "**Pasuri**" quhen parate (kartmonedha, monedha dhe banknota), monedha ari e argjendi, metale te çmuara te te gjitha llojeve, gure te çmuar e gjysem te çmuar (perfshire gure te çmuar te paperpunuar, aksione kupona dhe te gjitha llojet e letrave me vlere, çeqe, pulla, leter kredi, polica sigurimi, "bills of exchange, promissory note, certificate of deposit, money orders", dhe te gjitha instrumentat dhe kontratat e tjera te negociushme ose jo, qe perfaqsojne para ose pasuri te tjera.
 5. "**Çek**" quhet nje leter e shkembyeshme, e terhequr ne nje banke, e pagueshme ne kerkesa.
 6. "**Bill of Exchange**" quhet nje urdher me shkrim, i pakushtezuar, i adresuar nga nje person tek nje person tjeter, i siguruar nga personi qe e jep, duke i kerkuar personit te cilit i adresohet qe ti paguaj nje personi te specifikuar ose pruresit ne kerkesa, ose ne nje kohe te ardheshme te fiksuar apo percaktuar, nje shume te caktuar ne para.
 7. "**Certificate of Deposit**" quhet nje vertetim me shkrim e nje depozite nga nje banke me premtimin qe te paguaje depozituresin, me urdherin e tij, ose ndonje person tjeter me urdherin e tij.
 8. "**Promissory Note**" quhet nje premtim me shkrim i pakushtezuar, i bere nga nje person per nje tjeter, i nenshkruar nga beresi, duke marre persiper t'i paguaj, ne kerkesa ose na nje kohe te fiksuar apo percaktuar ne te ardhmen, nje shume te caktuar ne para, nje personi te caktuar ose mbajtesit te saj, ose me urdherin e tij.

PERJASHTIME TE PERGJITHSHME

Kjo police nuk mbulon:

1. Çdo humbje qe nuk zbulohet gjate periudhes se polices dhe çdo humbje te pesuar para dates se fillimit te percaktuar ne formular.
2. Çdo humbje qe rezulton teresisht ose pjeserisht nga veprimi ose mosveprimi i Drejtorit ose Drejtoreve te te Siguruarit, pavarsisht ne se eshte punonjes ose jo.
3. Çdo humbje qe rezulton direkt ose indirect nga nje ose me shume veprime te pandershme ose mashtruese te çdo njerit prej punonjesve te te Siguruarit, perveçse kur kjo humbje mbulohet nga klauzola nr.1.
3. Çdo humbje qe rezulton nga mospagesa teresore ose e pjesshme e ose veprimeve ndaj:
 - çdo huaje ose transaksiuni te se njejtes natyre me, ose qe kap shifrat e nje huaje te dhene apo marre nga I Siguruari, ose
 - çdo shenim llogarie, marreveshje ose deshmiertjeter borxhi te caktuar, ose shitur, ose zbritur ose fituar ne ndonje menyre tjeter nga i Siguruari, perveçse kur kjo humbje mbulohet nga klauzolat nr.1 ose nr. 4, rast ne te cilin shumat e kesaj humbjeje do te jete shumea e parave te paguara, avancuara ose terhequra duke zbritur te gjitha parate e

marra nga çfare do lloj burimi, perfshire pagesat dhe deftesat e interesit, komisionet dhe te tjera si keto.

4. Çdo humbje qe rezulton nga pagesat e kryera ose terheqjet nga çdo llogari depozitesi per shkak te pjeseve te pambledhura te depozites se kredituar nga i Siguruari per kete llogari, perfshire, pa kufizuar, gjeneralitetet e te siperpermendurit, Cheque Kiting and Crossfiring, pavarsisht ne se keto pagesa ose terheqje u shkaktuan ne mirebesim ose perms falsifikimit, mashtrimit, dredhise ose pretendimeve false, perfshire nje nje ose me shume veprime te pandershme ose mashtruese, te nje ose disa punonjesve te te Siguruarit.
5. Çdo humbje qe rezulton nga mungesa parash ne çdo sportel per shkak te gabimit, pavarsisht nga shume e kesaj mungese, dhe mungesat e parave ne sportel qe nuk e tejkalojne munges normale te parave ne sportel, ne zyren ku ndodh kjo mungese, do te pranohet te jete shkaktuar nga gabime.
6. Çdo humbje ose demtim i çdo pasurie çfaredoqofte qe ndodhet ne kutite e depozitave te klienteve, perveç se kur kjo humbje ose dem mbulohet nga klauzola 1.
7. Çdo humbje perms dorezimit te pasurise ne lokalini e te Siguruarit si rjedhoje e nje kercenimi.
8. Çdo humbje qe rezulton direkt ose indirekt nga manipulimi per se largu ose nga jashte lokalit i çdo sistemi kompjuterash te zoteruara, operuar teresisht ose pjeserisht nga i Siguruari, perveçse kur kjo humbje mbulohet nga klauzola 1.
9. Çdo humbje qe rezulton direkt ose indirekt nga falsifikimi ose modifikime mashtruese, perveçse kur kjo humbje mbulohet nga klauzolat 1, 4 ose 5.
10. Çdo humbje qe rezulton direkt ose indirekt nga falsifikimi ose modifikime mashtruese i, mbi ose ne çdo çek udhetari, leterkredite udhetari, llogari qe mund te terhiqen, police ngarkesa, deftesa magazinash, ose fatura e deftesa qe sherbejne per qellime te tilla, perveçse kur kjo humbje eshte parashikuar nga klauzola 1.
11. Çdo humbje qe rezulton nga karta krediti ose Charge Cards, pavarsusht ne se keto karta jne leshuar, ose nenkuptohen te jene leshua, nga i Siguruari ose çdo kush tjeter.
12. Çdo dhe secili dem per te cilat i Siguruari eshte ligjerisht perqiegjes, perveç demeve qe perfaqsojne rimborsime per humbje financiare te drejtperdrejta mbuluar nga kjo police.
13. Çdo humbje ose privim nga te ardhura te mundeshme, perfshire edhe dividentet, per shkak te nje humbjeje te mbuluar ne kete policwe.
14. Çdo humbje apo demtim te nçdo lloj pasurie per shkak te amortizimit, prishjes graduale, moles ose paraziteve.
15. Çdo humbje apo demtim te pasurise qe rjedh direkt ose indirekt nga stuhia, cikloni, shperthimi vullkanik, termeti, zjarri, ose fatkeqsi te tjera natyrore.
16. Çdo humbje ose demtim direkt ose indirekt qe ka lidhje me luften, invazionin, veprimet luftarake, luften civile, rebelimin, trubullirat civile, grushtin e shtetit ushtarak, trazirat ose veprimet e çdo autoriteti ta caktuar ligjerisht.
17. Çdo humbje qe rezulton direkt ose indirekt rezatimet jonizuese ose ndotjes radioactive, vetive toksike, eksplozime dhe veti te tjera te rrezikshme te njesive berthamore ose perberesve berthamore.



KUSHTE TE PERGJITHSHME

1. Mbulimi ne sigurim sipas kesaj police do te pushoje menjehere me rastin e likujdimit te te Siguruarit, ose caktimit te nje marresi ose drejtuesi, ose pjesemarrjes ne ndodnje skeme marreveshjeje apo bashkimi me kreditoret.

Ne keto raste i Siguruari duhet te njoftoje te Siguruarin me shkrim per:

- çdo bashkim apo shkrirje me nje vepriftari tjeter ose çdo blerje apo shitje te pasurive apo aktioneve qe shkakton ndryshim ne pronesine ose kontrollin financier te vepriftarise tjeter,
- marrjen nga çdo qeveri ose zyrtaret e emeruar prej qeverise te kontrollit te te Siguruarit.

Eshet kusht per vazhdimin e mbulimit, qe i Siguruari t'i jape menjehere Siguruesit informacionin qe Siguruesi do te kerkoje dhe i Siguruari te paguaj primin shtese, si pasoje e ketij ndryshimi.

Sidoqoftë mosnjoftimi i ketyre transaksioneve Brenda 30 diteve, nga data e fillimit te transaksioneve, do te perbeje nje zgjedhje te te Siguruarit per te perfunduar mbulimin me kete police. Njoftimi i transaksionit nga i Siguruari do te quhet i kryer vetem pasi te jete konfirmuar me shkrim nga Siguruesi.

2. Kjo police do te perfundoje menjehere ne rastin e:

- refuzimit te Siguruesit per te vazhduar mbulimin pas ndryshimit ne pronesi ose kontrollin e vepriftarise, siç parashikohet ne pikën 1 nesiper,
- mosnjoftimit te te Siguruarit per bashkin shkrirjen, ose ndryshimin ne pronesi, siç parashikohet ne pikën 1 mesiper,
- menjehere me marrjen nga Siguruesi te kerkeses me shkrim te te Siguruarit per te perfunduar kete police
- 30 dite pasi i Siguruari te kete marre njoftim me shkrim nga Siguruesi per perfundimin e kesaj police. Ky njoftim do te quhet te jete marre kur eshte derguar me poste te regjistruar e parapaguar, e adresuar ne zyren qendrore te te Siguruarit.

3. Per kete sigurim do te zbatohet pjese e zbritshme e cila do te caktohet sipas kushteve te paraqitura.

KUFIRI I PERGJEGJESISE

1. Pagesa e humbjes sipas kesaj police nuk do te zvogeloje pergjegjesine e Siguruesit per demet e tjera te mbuluara nga kjo police, gjithmon me kusht qe:

- pergjegjesia e pergjithshme e Siguruesve per llogari te çdo humbje ose humbjesh ose serie humbjesh te shkaktuar nga veprime ose mosveprime te çdo personi, pavarsisht ne se eshte njeri prej punonjesve te te Siguruarit ose jo, nuk do te kaloje kufirin kufirin e demshperblimit te klauzoles se zbatueshme ne kete rast, sipas percaktimit ne Formular
- ne qofte se, dhe vetem ne se, nuk ka veprime ose mosveprime te tillë direkte ose indirekte, pergjegjesia e pergjithshme e Siguruesve per llogari te çdo humbje ose seri humbjesh te rjedhura nga e njejtë ngjarje nuk do te kaloje kufirin e demshperblimit te klauzoles se zbatueshme,



-
- ne se do te zbatohen me shume se nje klauzole, perjegjesia e perjitheshme e Siguruesit nuk do te kaloje kufirin e demshperblimit sipas njeres prej klauzolave te zbatueshme, te percaktuar ne formular dhe ne asnje rast nuk do te mblidhen kufijte e veçante te demshperblimit, sipas klauzolave te veçanta.

DEMSHPERBLIMI

1. Ne rastin e ngjarjes se sigurimit, i Siguruari duhet te njoftoje me shkrim Siguruesin brenda 30 diteve nga data e zbulimit te humbjes nga i Siguruari. Gjithashtu, i Siguruari Brenda 3 muajve, nga ky zbulim, do ti paraqese Siguruesit provat qe vertetojne kete humbje, se bashku me detajet.
2. Siguruesi, ne çdo kohe, do te kete te drejten te marre persiper dhe drejtoje ne emer te te Siguruarit mbrojtjen e çdo kerkese per demshperblim, padie gjyqsore ose precedim ligjor. Nenkuptohet se na rast humbje, kur kjo nuk e kalon pjesen e zbritshme te zbatueshme, Siguruesi nuk eshte perjegjes per komisione, kosto dhe shpenzime. Gjithashtu shpenzimet per komisionet, kostot dhe shpenzimet e tjera te bera nga i Siguruari do te mbulohen ne rast se per keto eshte dhene me pare pelqimi me shkrim i Siguruesit.
3. Vleresimi i letrave me vlore dhe i valutave te huaja, per humbjet qe do te behet kerkese per demshperblim, do te percaktohet nga vlera e tyre ne mbylljen e tregut ne diten e fundit te veprimtarise, perpara dates se zbulimit te humbjes.
4. Ne rast se I Siguruari do te beje kerkese per demshperblim duke ditur se kjo kerkese eshte false ose mashtruese, kjo Police do te behet e pavlefshme dhe te gjitha kerkesat per demshperblim sipas saj do te anullohen.
5. Ne rast se Siguruesi nuk paguan vleren e pretenduar nga i Siguruari, ky i fundit ka te drejte ti drejtohet Gjykates se Faktit ne qytetin ku ndodhet zyra qendrore e te Siguruarit